



UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

Rruga Milto Tutulani , Albania, Tel +355 4 2230369

Mendimet dhe sugjerimet e Fakultetit të Shkencave Sociale për draft-ligjin në Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor

Drejtuar: REKTORATIT TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Këshillit të Fakultetit të Shkencave Sociale, diskutoi mbi mendimet e sjella nga departamentet lidhur me draft-ligjin në Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe konstaton se ky draft-ligj ka këto probleme:

A. Probleme konceptuale

1. Nuk është e qartë çfarë nënkupton ligji me shtetin. Nëse shteti është qeveria, siç nënkuptohet, atëherë ligji paraqet problematika të mbivendosjes së qeverisë në lirinë dhe autonominë akademike. Kjo pasqyrohet në nenin 3.

2. Projektligji është konceptuar sipas modelit të kontrollit të shtetit, duke mbajtur nën kontroll shumë çështje të arsimit të lartë dhe të universiteteve në kundërshtim me Magna Carta dhe dokumentet e Procesit të Bolonjës.

Kjo pasqyrohet në këto nene: neni 7/2, e, 3 a,b e; neni 8/3; neni:14/2; neni 15/3; neni 17/6; neni 18/3,6; neni 20/3,5; neni 32/3; neni 63/1.d, 3; neni 64; neni 72/2; neni 72/5; neni 78/2.b; neni 80/3, 4; neni 81/3; neni 100/1; neni 101/3; neni 112/2; neni 113/6.

Përgjegjësia që shteti ka ndaj taksapaguesve nuk i jep të drejtën atij që të ndërhyjë në veprimtarinë e universiteteve. Kushtetuta e RSh neni 57/7 përcakton se liria e institucioneve të arsimit të lartë dhe atyre akademike janë të garantuara me ligj.

3. Projektligji mbivlerëson rolin e shtetit, nuk respekton parimin e subsidiaritetit, pra nuk ia delegon atë pushtet që i takon universiteteve. Ky ligj ka në themel parimin e centralizimit të pushtetit. Pushteti që u duhet dhënë universiteteve është përqendruar në duar e Këshillit të Ministrave, Kryeministrit. Madje edhe disa kompetenca që projekt-ligji i mëparshëm ia kishte dhënë Ministrit, me këtë projektligj i kalojnë Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit. Kjo

pasqyrohet në nenet: neni 7/2.e; neni 8/3; neni 14/2; neni 17/6; neni 18/3, 6; neni 77/1; neni 78/2, 5; neni 80/4/; neni 81/3; neni 112/2; neni 113/6;

4. Projektligji nuk pasqyron drejt dhe qartë parimin e autonomisë akademike, llogaridhënies dhe përgjegjësisë. Madje liria akademike përmendet shkarazi vetëm një herë. Autonomia akademike është një fabrikim i ri, pasi në nivel evropian (Procesi i Bolonjës) dhe ndërkombëtar nënvizohet liria akademike, që është thelbi i filozofisë së arsimit të lartë.

5. Projektligji nuk shpreh qartë dallimin ndërmjet qeverisjes dhe menaxhimit si në nivelin e IAL (Senati, Bordi i administrimit) dhe veçanërisht në nivelin e njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Nuk përcaktohet se si realizohet qeverisja më nivelin e njësisë kryesore.

6. Projektligji përmban shumë organizma publikë dhe aktorë në funksion të AL dhe shumë organizma brenda IAL të financuar nga shteti. Disa prej tyre janë rregulluar me detaje duke tejkaluar natyrën e ligjit, ndërsa për disa të tjerë projektligji shprehet përciptaz ose në mënyrë të paqartë.

Jepen rregulla të detajuara të trajtës së VKM ose të rregullave të statutit për:

- a. Qendra e Shërbimeve Arsimore Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, të cilës i atribuohen kompetenca të centralizuara, që duhet të jenë kompetenca të IAL,
- b. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, të cilës i jepen përgjegjësi si mbi kontrollin e cilësisë së mësimdhënies, ashtu edhe të kërkimit shkencor (Neni. 16)
- c. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, ndërkohë që ka një ligj për shkencën dhe zhvillimin teknologjik. Parimi i transparencës është i paplotë. Ndërkohë që bordi i akreditimit duhet të jetë i pavarur, ligji ia kalon kompetencën e emërimit në nivel Kryeministrie, duke shfaqur kthim prapa nga kompetencat e pavarësisë.

Projektligji është i paqartë dhe i përciptë për:

- KALKSh,
- Asambleja e personelit akademik,
- Komisionet e përhershme,
- Administratori i njësisë bazë,

7. Projektligji merr përsipër të rregullojë edhe kërkimin shkencor, por faktikisht projekti i paraqitur nuk e justifikon titullin e tij. Ndërkohë që ekziston një ligj për shkencën dhe zhvillimin teknologjik, ky projektligj nuk shprehet sesi do të ndërliidhen këto dy ligje për kërkimin shkencor.

8. Projektligji nuk përmban parime të arsimit të lartë, ndërkohë që parimet janë piketat udhërefyese të një ligji.

9. Projektligji nuk reflekton ndryshimet në nivel global, ai ka pak referenca evropiane.

10. Projektligji është konceptuar si një dokument që ka hollësinë si tipar, ndërkohë që ligji duhet të ishte konceptuar si rregullator parimesh.

11. Koncepti i institucioneve të pavarura publike është i paqartë. Kjo nënkupton që IAL e tjera Publike janë të varura, pra nën vartësinë e Qeverisë. Kjo krijon mundësi për abuzim dhe tejkallim kompetencash dhe mundësi të pabarabarta zhvillimi. Neni 126, 127, 128, 129, 130.

B. Projektligji bie në kundërshtim me legjislacionin kryesor vendas, me Deklaratën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe me standardet evropiane.

1. Nene që bien ndesh me Kushtetutën dhe legjislacionin vendas:

- Neni 3/8, Neni 38,
- Nenet që lidhen me financimin
- Nenet që lidhen me krijimin e institucioneve të pavarura publike, neni 126/1.

2. Nene që bien ndesh me Deklaratën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dokumentet e Procesit të Bolonjës dhe të UNESCO:

- Neni 3, pika 8; Neni 1/b; Neni 1; Neni 6; Neni 7/e; 7/3.a,b; Neni 8; Neni 14/2; Neni 16/6; Neni 17/6; Neni 18/3; Neni 18/6; Neni 38/7; Neni 65/1.d, 3; Neni 68/3; Neni 77/1;

3. Projektligji nuk shpreh harmoninë me ligje të tjera vendase, si Ligji për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, Ligji për Shkencën dhe zhvillimin teknologjik, Ligji për arsimin parauniversitar, Ligji për shoqëritë tregtare, Ligji për Shoqërinë Civile, Ligji për Buxhetin e Shtetit.

C. Projektligji nuk plotëson parimet universitare të pranuar universalisht

1. Ligji e sheh arsimin si një shërbim publik, ndërkohë që Konferenca e fundit Botërore e Arsimit të Lartë (UNESCO 2009) mbas debateve të forta e ka kundërshtuar këtë parim dhe ka miratuar me konsensusin e 150 vendeve pjesëmarrëse parimin se arsimi i lartë është një e mirë publike. Po ashtu dokumentet e Procesit të Bolonjës e përcaktojnë arsimin e lartë si të mirë dhe përgjegjësi publike.

2. Parimi i autonomisë është i kufizuar krahasuar me Ligjin e 2007. Administrimi i universitetit duhet të realizohet nga vetë universiteti dhe jo nga agjencitë e shumta që janë shtuar, të cilat shtojnë burokracinë, në mënyrë që të realizohet konkretisht autonomia e universitetit e cila rezulton me fjalë në Nenin 4, por nuk rezulton në procese konkrete.

- a. Parimi i lirisë akademike është i papërcaktuar.

- b. Parimi i dallimit ndërmjet qeverisjes dhe menaxhimit nuk është paraqitur drejt, duke i kaluar kompetencat vendimmarrëse Bordit Administrativ, që ka më shumë peshë se Senati.
 - c. Kufizohet vlerësimi i brendshëm vetëm tek mendimet e studentëve (Neni 110/1), duke dëmtuar lirinë akademike.
 - d. Parimi i transparencës është i paplotë.
3. Ligji nuk garanton pavarësi të procesit të akreditimit për qa kohë sa Kryeministri emëron dhe miraton drejtuesin e Agjencisë, anëtarët e Bordit të akreditimit. Shembulli aktual i Bordit të të Akreditimit dëshmon se ka anëtarë që janë emëruar në shkelje të legjislacionit pasi kanë konflikt interesi duke qenë drejtues të IAL. Ky shembull dëshmon se ky organ nuk mundëson pavarësi.

D. Ligji përmban probleme teknike

1. Shkrimi i ligjit krijon dykuptimësi, paqartësi, mbivendosje.

Neni 42/7; Neni 45/2; Neni 46/2; Neni 48/3; Neni 49.

2. Ka nene që më tepër i takojnë akteve nënligjore sesa ligjit.

Neni 10; Neni 11; Neni 12; Neni 13; Neni 55; Neni 57; Neni 59; Neni 64; Neni 68; Neni 110.

3. Ka përdorim të pasaktë të termave: Neni 1/b; Neni 6; Neni 42/5; Neni 44/c.

4. Ligji ka paqartësitë në koncepte, fjali të e gjata e të ndërlikuara nuk janë tipike për standardin e formulimit të ligjeve.

5. Mundësitë e zhvillimit të stafit akademik tkurren, duke krijuar mundësi që Rektori dhe Dekani të vijnë dhe nga jashtë IAL. Neni 42/3; Neni 45/2.

6. Neni 36: "Statuti hartohet nga senati dhe administratori dhe miratohet nga Bordi i Administrimit që është me shumicë organ qeveritar", ndërkohë që në nenin 40 thuhet se "Senati është organi kolegjal më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë". Ky është një nonsens në arsyetim ligjor, një organ kolegjal që nuk miraton dot as Statutin e vet nuk është organ kolegjal.

7. Neni 28, pika 6: "*Departamenti përcakton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi si dhe përzgjedh studentët fitues*" Si i përzgjedh departamenti studentët fitues? A nuk e bën AQSH mbi bazën e provimeve që organizon?

E. Ligji përmban probleme të zbatimit

Probleme të zbatimit lidhen me zbatimin e një sërë nenesh të cilat janë të paqarta dhe për to nuk parashikohen as akte nënligjore.

- 1. Nenet që lidhen me procedurat e pranimit të studentëve nëpërmjet QSHA,
- 2. Nenet që lidhen me procedurat financiare,

3. Nenet që lidhen me funksionimin e asamblesë së personelit akademik
4. Nene që lidhen me komisionet e përhershme
5. Nene që lidhen me përcaktimin e statuese të veçanta
6. Nene që lidhen me qeversijen e njësive kryesore dhe bazë.

F. Probleme të financimit

1. Në shumë nene flitet për buxhet por nuk del qartë se sa është i gatshëm shteti të financojë në universitet publike (sa %) dhe pse shteti duhet të ndërhyje nëpërmjet Bordit të Administrimit se ku shkojnë të ardhurat që përfiton një departament. Pse të mos i vendosë departamenti në emër të autonomisë formale që i jep ligji. Pse Bordi mund t'i transferojë këto të ardhura në një fushë strategjike që e gjykon ai jashtë departamentit që i ka siguruar.
2. Neni 68, pika 3, Të qartësohet nëse është fjala për shërbime, konsulenca si pjesë e projekteve kërkimore/shërbimeve që ofron si personel akademik apo për ato individuale. Sepse nuk mund të kufizohet puna kërkimore e pedagogut.
3. Neni 114: Duhet të përcaktohet se financimi nga Buxheti i Shtetit bëhet vetëm për institucionet publike dhe jo për të gjitha.
4. Neni 118: Shpërndarja e fondit për infrastrukturën mbi bazën e renditjes: po nevojat e institucioneve publike nuk do të merren parasysh?
5. Neni 129, pika 1ç: *“fonde të tjera të akorduara nga Buxheti i Shtetit mbi të cilat është rënë dakord me institucionin e arsimit të lartë”*. Kjo mundësi është vetëm në rastin e institucioneve të pavarura të arsimit të lartë, nuk është as te publiket as te jopubliket. Të qartësohet se për çfarë mund të bien dakord?

E. Të tjera

6. Pika 4 e Nenit 71 duhet të hiqet nga ligji pasi këto marrëdhënie rregullohen me kodin e punës i cili si akt ligjor qëndron mbi ligjet dhe konkretisht bie ndesh me nenin 146 pika 2 dhe 3 të Kodit të Punës.
7. Neni 18, pika 3 thekson se AKKSH organizon çdo 4 vjet vlerësimin për kërkimin shkencor të IAL si dhe renditjen e IAL, bie ndesh me pikën 1 të po këtij neni, ku detyra kryesore e saj është shpërndarja e fondeve, po ashtu bie ndesh edhe me nenin 16 pika 1, ku ASCAL ka për detyrë të bëjë vlerësimi e cilësisë së kërkimit shkencor. Pra ka një mbivendosi dhe konfuzion të detyrave midis AKKSh dhe ASCAL.
8. Neni 33, programet e përbashkëta të studimit, në këtë nen duhet të përfshihet dhe programi i përgatitjes së mësuesve (MSH dhe MP) si programe të përbashkëta midis dy

njësive bazë. Kjo për faktin se pjesa shkencore organizohet nga departamenti përkatës dhe pjesa psiko-pedagogjike realizohet nga Departamentet e edukimit.

9. Në Nenin 35 të shtohet edhe sasia e krediteve që duhet të ketë pjesa e përgatitjes profesionale pra e përgatitjes psiko-pedagogjike të mësuesve. Një përcaktim i tillë do të unifikojë si dhe do të ndihmojë në rritjen e nivelit psiko pedagogjike të mësuesit. Departamentet duke iu përgjigjur në masën 80% unifikimit në programet e mësuesisë sipas ligjit do të mund të realizojnë në këtë shifër si unifikimin e pjesë shkencore ashtu edhe të pjesës pedagogjike.
10. Në draft ligj duhet të ketë një dispozita kalimtare ku të përcaktojë një afat ku departamentet të plotësojnë kriterin që të mbulojnë me staf të brendshëm 2/3 e programeve. Kjo sepse shumica e departamenteve nuk e plotësojnë këtë kriter dhe jo të faj të tyre, por sepse qeveritë nuk u kanë dhënë stafin e nevojshëm fakulteteve në vite.
11. Organet kolegjiale si Këshilli i Fakultetit zëvendësohen me asamblenë e pedagogëve, por a ka mundësi teknikisht që kjo asamble të shqyrtojë çdo ndryshim në plan mësimesor që kërkon një departament?
12. Në nenin 68 Bordit të Administrimit i jepen kompetenca për punësimin e personelit akademik në një kohë që janë vetë departamentet që e dinë sa nevoja kanë për staf akademik të brendshëm e të ftuar për të realizuar një proces cilësor mësimdhënie. Edhe ky përbën një çenim të autonomisë.
13. Centralizimi i proceseve të regjistrimit dhe përzgjedhjes së aplikantëve për të gjitha ciklet e studimit nga një agjenci e vetme është e papërshtatshme veçanërisht për nivelet e 2-ta e të 3-ta të studimit. Neni 11 çenon autonominë e IAL. Vetë IAL duhet të organizojnë pranimin e studentëve në të gjitha ciklet.
14. Duhet theksuar në dispozitat kalimtare koha që u lihet në dispozicion Ndihmës-lectorëve (neni 62 pika 5) që nuk ka marre titullin lector, por ka lidhur më parë kontrate me kohëzgjatje të pacaktuar. Neni 62 pika 5, bie ndesh me nenin 690 i Kodit Civil i cili përcakton shprehimisht: Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.
15. Neni 62, pika 1: Të qartësohen “veprimtaritë e tjera” që kryen personeli akademik.
16. Neni 126, “Krijimi dhe transformimi në institucion të pavarur publik të arsimit të lartë”, ku themeluesi, sipas këtij draft-ligji, i transferon institucionit autonom të drejtën e pronësisë mbi pasuritë në përdorim të këtij të fundit, duke ruajtur të drejtat e themeluesit. Theksojmë se, jo çdo organizëm që quhet jofitimprurës është i tillë. Kur është i tillë, ai nuk mund të ketë as prona dhe të ardhura të lira që ti përdorë si kapital dhe aksione për të ndërtuar një universitet të pavarur publik. Ndërkohë që, sipas këtij draft-ligji, “Bordi i

administrimit në institucionet e pavarura publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, tre prej të cilëve zgjidhen nga senati akademik për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Rektori është anëtar i bordit të administrimit. Themeluesit e institucionit përfaqësohen në këtë organ përmes katër anëtarëve, në raport me kontributin e secilit themelues. Anëtarët e bordit të administrimit punësohen me kohë të plotë”. Themeluesi i një organizate jofitimprurëse nuk ka prona dhe të ardhura, dhe nuk mund të fitojë prej tyre, prandaj nuk mund të jetë fare aksioner në universitetin e pavarur publik.

17. Të mos ketë ndarje midis personelit akademik në personel akademik mësimdhënës dhe kërkimor. Të ulen orët e mësimit në favor të kërkimit shkencor.
18. Duhet të përcaktohet në ligj se stafi i brendshëm në IAL kualifikohet me fondet e IAL.
19. Duhet hequr kriteri i 5-së viteve për të fituar titujt Prof.As dhe Prof. Titujt shkencorë Prof.As dhe Prof duhet të akordohen duke u mbështetur në aktivitetin shkencor të kandidatit pa patur kufizime 5 vjet.
20. Duhet të sqarohet roli i administratorit, në department, pasi ka pak punë për të.

Për sa më sipër draft- ligji cenon lirinë akademike, cenon autonominë e institucioneve të IAL, si dhe favorizon në mënyrë të hapur institucionet jo publike.

Këshilli i Fakultetit të Shkencave Sociale